



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1396/3 prot.

Datë 23.06.2023

V E N D I M
Nr. 515/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.06.2023, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3183 datë 16.06.2023 dhe nr. 1396 prot., datë 19.06.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-72128-06-09-2023, me objekt: “Rehabilitimi i stacioneve te autobuseve dhe i stacionit te taksive elektrike te Segmentit nga Shkolla e Marines deri te Regina City”, me fond limit 5,833,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë

Ankimues: “Ngracan 1934” SHPK
Lagjja Sheq i Madhe, rruga “Koçi Papuciu” ,banese private. Nr 53, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë
Sheshi “4 Heronjtë” Vlorë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “*Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.06.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-72128-06-09-2023, me objekt: “*Rehabilitimi i stacioneve të autobuseve dhe i stacionit të taksive elektrike të Segmentit nga Shkolla e Marines deri të Regina City*”, me fond limit 5,833,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 16.06.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3183 dhe nr.1396 prot., datë 19.06.2023 e operatorit ekonomik “*Ngracan 1934*” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Me shkresën nr.12 prot., datë 20.06.2023 protokolluar me tonën nr.1396/2 prot., datë 20.06.2023, operatori ekonomik ankimues “Ngracan 1934” SHPK nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-72128-06-09-2023, me objekt: “Rehabilitimi i stacioneve te autobuseve dhe i stacionit te taksive elektrike te Segmentit nga Shkolla e Marines deri te Regina City”, me fond limit 5,833,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.4. Nëpërmjet shkresës së mësipërme operatori ekonomik ankimues “Ngracan 1934” SHPK shprehet se:

“Kerkese e operatorit ekonomik “Ngracan 1934” sh.p.k me nipt J876028095 per terheqje nga ankesa me Nr.Ankimi A/72023/3183 date 16.06.2023 per “Ankesë për dokumentet e tenderit” per tenderin me objekt “Rehabilitimi i stacioneve te autobuseve dhe i stacionit te taksive elektrike te Segmentit nga Shkolla e Marines deri te Regina City” me nr. REF-72128-06-09-2023 me fond limit 5.833.333,00 leke per arsye personale dhe te angazhimeve te tjera, nuk jemi te interesuar per te ndjekur kete procedure ne fazat e metejshme.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Ngracan 1934” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-72128-06-09-2023, me objekt: “Rehabilitimi i stacioneve te autobuseve dhe i stacionit te taksive elektrike te Segmentit nga Shkolla e Marines deri te Regina City”, me fond limit 5,833,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të

afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3183 dhe nr.1396 prot., datë 19.06.2023 për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-72128-06-09-2023, me objekt: “Rehabilitimi i stacioneve të autobusëve dhe i stacionit të taksive elektrike të Segmentit nga Shkolla e Marines deri të Regina City”, me fond limit 5,833,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 23.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ngracan 1934” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

